



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI**

URDHËR

Nr. 40, datë 8.10 2018

MBI

“MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE, PËR PRANIMET E APLIKIMEVE TË STUDENTËVE, NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER PROFESIONAL, MASTER I SHKENCAVE, MASTER I ARTEVE TË BUKURA, NË FAKULTETET E UNIVERSITETIT TË ARTEVE”

Bazuar në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Kreu IV/4 të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Arsimit nr. 18, datë 21.15.2018 për “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2018-2019” (i ndryshuar); VSA nr. 2, datë 10.01.2018; VSA nr. 3, datë 10.01.2018; VSA nr. 4, datë 10.01.2018; VSA nr. 6, datë 01.03.2018; VSA nr. 7, datë 01.03.2018 si dhe në VSA nr. 8, datë 01.03.2018,

URDHËROJ:

1. Marrjen e masave organizative, për pranimet e aplikimeve të studentëve, në ciklin e dytë të studimeve, në Fakultetet e Universitetit të Arteve.
2. Aplikimet për regjistrim në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë do të bëhen pranë sekretarive mësimore të Fakulteteve të UAR, deri në datë 12 Tetor 2018.
3. Brenda datës 22 Tetor, Fakultetet e UAR, të shpallin aplikantët fitues dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në ambientet e Fakulteteve përkatës, si dhe në faqen e internetit (web) të UAR, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara.
4. Aplikantët kanë të drejtën e ankimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. Fakultetet të shprehin me vendim të argumentuar, lidhur me ankimin, brenda 2 (dy) ditëve pune, nga data e paraqitjes së ankesës.
5. Regjistrimi i kandidatëve fitues, në programet e studimit ku janë shpallur fitues, do të kryhet pranë sekretarive mësimore të Fakulteteve të UAR, deri në datën 30. Tetor 2018.
6. Fakultetet e UAR, të afishojnë listat emërore të studentëve të regjistruar në ambientet e tyre, brenda datës 01 Nëntor 2018.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



7. Dekanët e Fakulteteve të UART, të marrin masat organizative për procesin e pranimit dhe të regjistrimit të aplikantëve, në ciklin e dytë të studimeve, verifikimin e dokumentacionit të pranimit sipas legjislacionit në fuqi.
8. Të drejtën e aplikimit, në një program studimi të ciklit të dytë Master, e kanë kandidatët që:
 - Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program studimi të ciklit të parë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe i akredituar në momentin e diplomimit të tij.
 - Studentë të cilët janë diplomuar jashtë vendit, në një program studimi të ciklit të parë, të licencuar dhe akredituar. Në rast pranimi, kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë MASR/QSHA, brenda muajit Dhjetor 2018.
9. Dokumentacioni për tu regjistruar që kandidatët duhet të paraqesin personalisht, ose nëpërmjet një personi të autorizuar prej tij, janë si më poshtë:
 - Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Fotokopje të kartës së identitetit ose të pasaportës. Diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës;
 - Në rast se kandidatët nuk kanë mundësi të paraqesin kartonin e diplomës ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë, për shkak të mos dhënies të kartonit të diplomës nga ana IAL-të ku kanë përfunduar studimet, të pranohen edhe vërtetimet e diplomave nga IAL-të përkatëse ku kanë përfunduar studimet, deri në marrjen e saj dhe plotësimit të plotë të dokumentacionit prej tij;
 - Diplomen e Matures Shtetërore së bashku me certifikaten e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e korifirmuar nga njesia përkatëse arsimore vendore (DARIZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, date 3.11.2010 të Keshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, date 8.2.2006 të Keshillit të Ministrave "Për krijimin e Matures Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta pub/ike", i ndryshuar, paraqesin Deftesen e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të korifirmuar nga njesia përkatëse arsimore vendore DARIZA).
Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë deftese pjekurie të shkolles së mesme, duhet të paraqesin dublikate të deftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkolles së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të korifirmuar nga njesia



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



perkatëse arsimore vendore (DARIZA), ose dokumentin e leshuar nga Arkivi i Shtetit se bashku me listen e notave;

- Formulari i aplikimit (sipas formatit të Shtojcës nr. 6, të Udhezimit nr. 26, datë 30.07.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2018-2019");
- Fotokopja e dokumentit të identifikimit (karte identiteti, leternjoftim ose pasaportë);
- Dy fotografi personale.

10. Kandidatët e huaj duhet të paraqesin dokumentacion shtesë, si më poshtë:

- Dëshmine e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë perfunduar një cikël/programstudimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri. Shtetasit e huaj që aplikojnë në baze të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet perkatëse;
- Curriculum Vitae;
- Deklaratën sipas Shtojcës nr. 5, të Udhezimit nr. 26, datë 30.07.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2018-2019");

11. Kandidatët e kategorive të veçanta, duhet të paraqesin dokumentacion shtesë, si më poshtë:

- Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuara duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së leshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP);
- Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të leshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.
- Kandidati nga komuniteti Rom dhe Ballkano-Egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetedeklarim ose një dokument që vërteton që është Rom apo Ballkano-Egjiptian.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



12. Pranë secilit Departament të Fakulteteve të UART të ngrihen komisionet ad hoc, për çdo program studimi të ciklit të dytë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe perzgjedhjen në baze të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe kriteret për do program studimi sipas kuotave përkatëse.
13. Konkursët për pranimin e kandidatëve, të zhvillohen pranë Fakulteteve të UART dhe fituesit të regjistrohen në sekretariatë mësimore përkatëse.
14. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht 2 (dy) programe studimi, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.
15. Brenda datës 18 nëntor 2018, Fakultetet e UART të dërgojnë në Rektorat listën e studentëve të regjistruar, për përcjelljen më pas të saj pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
16. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Web-it, të Universitetit të Arteve.
17. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Dekanët dhe sekretariatë e Fakulteteve të UART.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

